



VENDIM

Nr. 6 Datë 20.01.2010

PËR

**NDRYSHIMIN E LICENSËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË SHOQËRISË HIDROINVEST 1 SH.P.K ME SERI
PV08K, NR.66, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË
KOMISIONEREVE TË ERE-S NR.113, DT.24.09.2008**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 15 pika 4 gërmat “a” dhe “b” të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 20 .01.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “HIDROINVEST 1” sh.p.k për ndryshimin e liçensës Nr.66, Seria PV08K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.113, datë 24.09.2008 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Dhe konstatoi se:

- Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “HIDROINVEST 1 “sh.p.k ka nisur me marrjen e vendimit Nr.87 Datë 10.11.2009.
- Eshte paraqitur i plotë dokumentacioni per kete procedure sic kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”,

Vendosi:

1. Të ndryshojë liçensën me numër Nr.66, Seria PV08K, Aneksi A, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.113, datë 24.09.2008, të mbajtur nga shoqëria “HIDROINVEST 1” sh.p.k.

2. Kapaciteti i instaluar i HEC Stranik behet 4600 kW; Kapaciteti i instaluar i HEC Zall Tore behet 3000 kW.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



-
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s
Bujar Nepravishta

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



VENDIMIN

Nr. 6 Datë 20.01.2010

PËR

**NDRYSHIMIN E LICENSËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË SHOQËRISË HIDROINVEST 1 SH.P.K ME SERI
PV08K, NR.66, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË
KOMISIONEREVE TË ERE-S NR.113, DT.24.09.2008**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____

Adresa: Blvd "Gjergj Fishta"10
Tirane
E-mail erealb@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 22 963
Tel +355 42 69 590
www.ere.gov.al